



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2020:160588

Datë: 29.10.2024

Numri i dokumentit: 06365681

C.nr.1006/2020

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN Dega VITI, departamenti i përgjithshëm - divizioni civil, Gjyqtari Nexhat Aliu, me bashkëpunorën profesionale Lumturije Fetahu Xhelili, në çështjen kontestimore të paditësit R.N nga fshati D., Komuna e Vitisë, të cilin me autorizim e përfaqëson M.B. nga fshati D., Komuna e Vitisë, dhe M.A.avokat në Viti, kundër të paditurve R.S.dhe R.Z. që të dy ish nga Vitia, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm av. I.R.nga Vitia, dhe ndërhyrësit kryesor B.B.nga fshati D., Komuna e Vitisë, të cilin e përfaqëson Skender Shefkiu avokat nga Vitia, me objekt kontesti, vërtetimi i të drejtës së pronësisë, vlera e kontestit 2,500.00 €, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik me datë 24.10.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. Miratohet si e bazuar me ligj kërkesëpadia e paditësit R.N nga fshati D.ë, Komuan e Vitisë, e ushtruar kundër të paditurve R.S.dhe R.Z. që të dytë ish nga Vitia, në adresë të panjohur, me të cilën paditësi ka kërkuar që të vërtetohet ndaj të paditurëve, se paditësit në bazë të mbajtjes –parashkrimit fitues është bashkëpronarë nga 1/2 e pjesës ideale të paluajtshmërisë P-70101007-01468-0, e cila gjendet në vendin e quajtur „Jezero,, Zona Kadastrale Viti, në sipërfaqe prej 5475, e evidentuar sipas Certifikatës mbi të drejtat pronësore me numër të lëndës 3249/2020 në emër të R.S.dhe R.Z. , dhe të detyrohen të paditurit që të durojnë që kjo paluajtshmëri të regjistrohet në emër të tij, në afat porej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimti të dhunshëm ligjor.

II. Miratohet kërkesëpadia e ndërhyrësit kryesor Bejtush Bejta (Jakup) nga fshati D., Komuna e Vitisë, dhe vërtetohet ndaj të paditurve R.S.dhe R.Z. që të dytë ish nga Vitia, në adresë të panjohur, se ndërhyrësi kryesor në bazë të parashkrimit fitues- mbajtjes me mirëbesim është bashkëpronarë i paluajtshmërisë P-70101007-01468-0, nga 1/2 të pjesës ideale e cila gjendet në vendin e quajtur „Jezero,, Zona Kadastrale Viti, në sipërfaqe prej 5475, e evidentuar sipas Certifikatës mbi të drejtat pronësore me numër të lëndës 3249/2020 në emër të R.S.dhe R.Z. dhe të detyrohen të paditurit që të durojnë që kjo paluajtshmëri të regjistrohet në emër të tij, në afat porej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimti të dhunshëm ligjor.

III. Paditësi dhe ndërhyrësi kryesor i bartin shpenzimet e procedurës kontestimore.

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse .

Fillimisht, paditësi Remzi Bejat (Hazir) nga fshati D., Komuan e Vitisë , më datë 18.11.2020, në këtë gjykatë ka ushtruar padi për vërtetimin e të drejtës së pronësisë në bazë të mbajtjes, kundër të paditurve R.S.dhe R.Z., tani në adresë të panjohur, lidhur me ngastrën P-70101007-01468-0, e cila gjendet në vendin e quajtur „Jezero,, Zona Kadastrale Viti, në sipërfaqe prej 5475 dhe e cila te DGJKP në Viti është e evidentuar sipas fletës poseduese numër 3249/2020, në emër të R.S.dhe R.Z., duke konfirmuar se qysh se në vitin 1976, e kishte blerë pronën e lartëcekur duek bërë pagesën e tërsishëme të qmimint sipas marrëveshjes me të paditurit , dhe se menjëher pas kësaj ka hyrë në posedim të kësaj prone, duke e shfrytëzuar që nga atëherë e gjerë me tani, i pa penguar nga askush.

Meqenëse palëve të paditura, nuk është arritur që t'i dorëzohet padia në mënyrë të rregullt, pasi në adresën ekzistuese sipas shkresave të lëndës-fletëkthesës, rezulton se adresa e tyre është e panjohur, gjykata ka kërkuar nga Stacioni Policor në Viti, sigurimin e adresës dhe vendbanimit të tyre.

Pasi që nga ana e Policisë së Kosovës, nuk ka qenë e mundur të sigurohet adresa e të paditurëve me kërkesën e përfaqësuesit të paditësit, gjykata, të paditurëve, në pajtim me nenin 79 pika 3 dhe 81 të LPK-së, i ka caktuar përfaqësues të përkohshëm nga radha e avokatëve, për të mbrojtur të drejtat e tyre, vendim ky i cili është publikuar në tabelën e shpalljeve të gjykatës dhe në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, konform nenit 83 të LPK-së. Lidhur me këtë qështje, gjykata konform.

Përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurve, avokati I.R. nga Vitia, fillimisht e ka kundërshtuar kërkespadinë paditësit me përgjegjej në padi duke theksuar se nuk i ka bashkangjitur asnjë provë për të cilat do ti mbeshteste pretendimet e tij , duke i propozuar gjykates që të njëjtën ta refuzon si të pabazuar, si dhe i ka kërkuar shpenzimet e procedures për përfaqësues të përkohshëm.

Në fazën e shqyrtimit kryesor të dt. 22.10.2024, Bejtush Bejta përmes të autorizuarit të tij avokatit Skender Shefkui nga Vitia - përmes parashtresës ka kërkuar njohjen e statusit të palëse në proces si ndërhyrës kryesor, duke e prezentuar edhe interesin juridik për ndërhyrje, nga shkakut se nuk e ka ditur se paditësi të ketë inicuar procedurën kontestimore për ngastrën kontestuese sipas padisë fillestare, të njejtit kanë deklaruar se këtë paluajtshmëri e ka blerë prindi i tij Jakup Bejta tani i ndjerë, së bashku me prindin e paditësit fillestar Hazir Bejta tani i ndjerë dhe se në tërësi janë përmbushut detyrimet e tyre.

Ndërhyrësi kryesor sipas parashtresës së datës 22.10.2024, ka kërkuar që të vërtetohet ndaj të paditurve R.S.dhe R.Z.që të dy nga Vitia, tani në adresë të panjohur, se ndërhyrësi kryesor në bazë të parashkrimit fitues- mbajtjes me mirëbesim dhe shitblerjes është pronar i paluajtshmërisë P-70101007-01468-0, e cila gjendet në vendin e quajtur „Jezero,, Zona Kadastrale Viti, në sipërfaqe prej 5475 dhe e cila te DGJKP në Viti është e evidentuar sipas fletës poseduese numër 3249/2020 në emër të R.S.dhe R.Z., dhe të detyrohen të paditurit që të durojnë që kjo paluajtshmëri të regjistrohet në emër të ndërhyrsit kryesor, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën pasojat e përmbarimti të dhunshëm ligjor.

Ndërhyrësi kryesor pretendon se kjo e drejtë subjektive në këtë paluajtshmëri i takon në bazë të mbajtjes, shitblerjes, pasi që këtë palujtshmëri e ka blerë babai i tij i ndjeri nga të paditurit ne vitin 1976, dhe se ka hyrë në shfrytëzimin dhe posedimin të saj. Gjykata, pas dorëzimit të parashtresës për ndërhyrje të gjitha palëve paditëse dhe të përfaqësuesit të përkohshëm të paditurit, ka pranuar statusin e ndërhyrsi kryesor në këtë kontest përmes aktvendimit procedural, pasi që ka konstatuar se ekziston interesi juridik për ndërhyrje kryesore, meqë nga deklaratat e palës paditëse, paluajtshmëria kontestuese në sipërfaeqe prej 5475m2 është blerë ne 1/2 dhe se shfrytëzon 2735.5 m2 dhe në shrytëzimin e saj tani është ndërhyrësi kryesor i cili dhe për këtë vendim palët tjera nuk kanë pasur vërejtje.

Në fjalën e tyre përfundimtare përfaqësuesi i paditësit ka deklaruar se : pas shtjellimit dhe administrimit të provave u vërtetuar baza juridike e kërkespadi se paditesit me daljen e gjykates ne vendin e ngjarjes me ekspert të gjeodet i cili ka bër vrojtimin drejte për drejte te ngastres po ashtu edhe me te besueshme padin e paditesit e kan bër edhe ndegjimi i tre dëshmitarve të cilit kishin njohuri rreth shitbleres dhe posedimit me mirbesimi më tepër se 20 viteve ateher nga këto arsye kerkojme nga gjykata qe paditesit ti njihet e drejta e pronesi ne ngastren me nr.1468 nga siperfaqja e pergjitheshme 5475 ne 1/2 nga kjo sipefaqe qe nen kupton ne pjesen lindore ne baze te mbajtjes mbi 20 viteve dhe njëkohësishte nuk ja kontestoj pjesen tjeter te paditesit te ri Bejtush Bejta.

Përfaqësuesi i ndërhyrsit kryesor në fjalën përfundimtare ka deklaruar se: paditesit te ri Bejtush Bejta av.Skender Shefkui ne fjalen përfundimtare deklarone:Pajtohem plotesishte me fjalen përfundimtare lidhur me kete qeshtje.Dhe kerkojme ne baze te gjitha te cekurave qe pales sime ti njihet e drejta pronesore ne siperfaqe prej 1/2 e ngastres kadastrale nr.1468 nga ana perendimore siq eshte vërtetuar nga gjendja faktike e posedimet dhe shfrytezimit te pa penguar qe nga koha e bleres mateperme se 40 viteve.

Përfaqësuesi i përkohshëm i të paditurve, avokati I.R. nga Viti, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se : pas administrimit të provave dhe ndegjimit të dëshmitarëve konsideron se kërkespadina e paditesit dhe ndërhyrsit kryesor është e pa bazuar, duke i propozuar gjykates që në bazë të provave të administruar të vendos lidhur me këtë qështje

Provat e administruara në shqyrtimin kryesor

Për të vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë pretendimet e palëve ndërgjyqjese si dhe për të vërtetuar drejtë gjendjen faktike në këtë çështje juridike civile, gjykata i ka administruar dhe vlerësuar këto prova: Cerifikaten e pronësis me numër të lëndës 3249/2020, kopjen e planit e dt.17.11.2020, përgjegjjen e Stacionit policor në Viti datës 01.09.2024, përgjegjjen nga AKPKVP me numër 01284/24/hjg e dt.02.09.2024, ekspertizen e gjeodetit Tajar Neziri e dt.17.10.2024 si dhe ka ndëgjuar dëshmitarët Islam Rrahmani, Driton Bejta, dhe përfaqësuesin e paditësit të parë Remzi Bejat, M.B..

Seanca e vendshiqimit

Pas daljes në vendshikim me datë16.10.2024, në prezencë të gjykatës dhe palëve eksperti gjeodet duke vepruar sipas urdhrorit të gjykatës, u konstatua se në ngastrën 1468, e cila ngastre me kultur është livadh dhe për nga gjatesia shtrihet në lindje perendim, ndërsa nga gjersia jug-veri Përfaqësuesi i përkohshëm nuk ka pasur vërejtje.

Konstatimi i ekspertit gjeodet

Në konstatimin e tij, eksperti i gjeodezis¹, ka gjetur se: ngastrën kadastrale nr. 1468-0, ZK Viti, me sipërfaqe prej 5475m², në vendin e quajtur " Jezero, ", tokë bujqësore, e cila në pjesën veriore kufizohet me parcelën 1467-0- nga pika 1 deri te pika 2 me gjatësi prej 149.98 dhe nga pika 2 deri në piken 3 me gjatësi 109.69m, nga ana lindore kufizohet me parcelën nr.1469-0, nga pika 3 deri në piken 4 me gjatësi prej 2.70 m dhe me parcelen nr.1475-0 nga pika 4 deri te pika 5 me gjatësi prej 19.35m nga ana jugore me parcelën nr.1476-0, nga pika 5 deri te pika 6 me gjatësi prej 113.66 m, dhe nga pika 6 deri te piak 7 me gjatësi prej 152.25m, dhe nga ana Perendimore me parcelën nr.170-2, nga pika 7 deri te pika 1 me gjatësi prej 20.84 m.

Përmbledhje e deklaratave të dëshmitarëve

Dëshmitari Islam Rrahmani në seancën e shqyrtimit kryesor, ndër të tjera ka deklaruar: se këtë ngaster e kishte punuar disa here pas lufte ku edhe sot e punon e cila me kultur është livadh te njeiten e kishte marr nga Bejtush Bejta, e kishte marrur pjesen e tij, e cila gjindet nga pjesa perendimore, nuk ka ndëgjuar asnjëherë që të jetë ankuar ndonjë qytetare lidhur me keto ngastëra. Këto ngastra faktikisht ekziston një kufi në mes tyre, ndersa juridikisht janë nga 1/2, në atë kohe këto ngastra ishin blere me dinar jugosllave nga se dinari jugosllave ka qen ne qarkullim, e din se ku gjindet kjo ngastër, gjindet në rrugen Viti-Sllatinë përtej kanalit, afer 100 metra nga kanali, gjindet në anen e djathte te rruges, edhe pjesa tjeter është punuar ndonjëher, ndonjëher nuk ishte panuar fare. Asnjeher nuk kan pasur ndonjë pengese qofte nga te paditurit apo ndonji person tjetër, ka njohuri qe kjo toke është e paditesve që shumë vite. Se këtë Jakupi babai i Bejtushit e kishte marë dhe e kishte derguar tek ara per ta punuar (për të cilen po flasim) se këtë ngaster e kishin blere nga qytetaret e nacionalitetit serb, i kishte thënë se keto ngastra jan paguar ne teresi, nuk ka ndergjuar nga askush që të jete ankuar ndonjë qytetar inacionalitet serb apo nacionaliteteve tjera lidhur me këto ngastra, gjykata ja fali besimin të njetës deklarat

Dëshmitari Driton Bejta, në seancën e shqyrtimit kryesor, ndër të tjera ka deklaruar, se ndërhyrsin e ka në afërsi ndersa paditësin Remzi Bejta e ka djale të mixhës, me tej deshmitari shton se e dinë se kete ngaster e kan blere paditesi dhe paditesi i ri, te cilen ngaster ai vete e ka punuar pase Lufte por edhe para Lufte, e kam punuar vetem pjesen, e cila gjindet nga pjesa perendimore ku si padites i ri është Bejtush Bejta, mirpo nje kohe kishte qen jashte shtetit e kur kishte qenë jashtë shtetit nuk e di se kush e kishte punuar, ndersa pjesen tjeter e kishte punuar djali i mixhes Basria, i cili eshte vellau i Remziut, nuk ka degjuar që të jete ankuar ndonjë qytetar lidhur me keto ngastra, e din këtë faktë se prindërit e tyre ju thojshin se këtë ngaster e kemi blere nga dy serb, kete pasuri e kishin blere pasi që ishin shpërgulur nga fsh.Ballace dhe ishin vendosur ne fsh.D., ku edhe kete ngaster e kishin blere, me te hollat te cilat e kishin shitur pasurien në fsh.Ballance, gjykata ja fali besimin të njetës deklarat

Përfaqësuesi i paditësit Remzi Bejta-Meriton Bejta është ndëgjuar në cilësisjen e palës, i cili në seancën e shqyrtimit kryesor, ndër të tjera ka deklaruar se: Kjo ngaster ishte blere ne vitin 1976-1977 nga Remzi Bejta i cili ka qen krye familjar, të cilet me nderhyrsin kan qen në nje bashkesi familjare dhe kontribut për blerjen e kësaj ngastrë kan dhen te gjith familja, ndersa bashkesia familjare ishte ndar diku në vitin 90. Dhe atëher ishte bere ndarja e ngastrave ne menyre faktike nga familjaret, ku nje pjese e kesaj ngastre i ka takuar paditesit Remzi Bejta, nga ana lindore, ndersa pjesa tjeter i ka takuar nderhyrsit Bejtush Bejta nga ana perendimore, qe do te thote se jan ndare përgjysëm, familja e tyre në përgjithësi gjinden ne shtetin e Austrise ndersa ngastren e mban mend se edhe vete e kishte punuar mirpo shumicen e rasteve ja kishin dhën me qira nje personit i qujtur Bashkim nga D.i i Poshtem, Asnjëher nuk kishin pasur problem nga ndonjë qytetar të nacionalitetit serb dhe gjithë fsh.D. e din se është ngastra e tyre (paditësve). Arsyeja e bartjes është neglizhenca pasi që familjarët e tyre ishin jashte shtetit, gjykata ja fali besimin të njetës deklarat.

Provat materiale

Me leximin e Certifikates së prones me nr.3249/2020 e dates 17.11.2020 per ngastren kadastrale me nr. 01468-0 dhe kopjes së planit, gjykata ka vërtetuar se palujtshmeria kontestuese është ne emer te R.S.dhe R.Z. dhe atë në 1/2.

Sipas përgjigjes së Stacionit policor në Viti datës 01.09.2024, gjykata është informuar se të paditurit R.S.dhe R.Z., nuk jetojnë në Viti, por të njejit jetojnë në shtetin e Serbisë dhe nuk i dihet adresa e saktë.

Sipas përgjigjes nga AKKVP, me nr.ref., me numër 01284/24/hjg e dt.02.09.2024, gjykata është informuar se për ngastren kontestuese, asnjë person, qoftë fizik apo juridik, nuk ka paraqitur asnjë kërkesë, ankesë apo çfarë do pretendimi tjetër pasuror- pronësor.

Gjendja faktike e vërtetuar

Pas vlerësimit me kujdes të secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku si dhe në bazë të rezultatit të procedurës së zhvilluar kontestimore, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike:

Nga provat e administruara Gjykata vërtetoi se babi i paditësit dhe ndërhyrsit kryesor , në vitin 1976 e kan blerë nga R.S.dhe R.Z. ish nga Vitia , paluajshmerinë – ngastrën kadastrale nr. ngastrën P-70101007-01468-0, e cila gjendet në vendin e quajtur „Jezero,, Zona Kadastrale Viti, Po ashtu, gjykata vërtetoi së paditësi dhe ndërhyrsi kryesor ngastrën kontestuese, e kan në shfrytëzim të qetë e të pa penguar nga askush për më tepër se 40 vite, fakte këto të vërtetuara nga deklaratat e dëshmitarëve Islam Rrahmani, Driton Bejta dhe M.B. , të cilat ishin në përputhje me njëra tjetrën dhe se me dëgjimin e tyre është vërtetuar pretendimi i paditësit të theksuar në padi, dhe pretendimi i ndërhyrsit kryesor i theksuar në parashtresën e datës 22.10.2024, andaj edhe Gjykata ja fali besimin në tërësi , gjykata ka vërtetuar se ngastrën kadastrale nr.. 1468-0 ZK Viti, me sipërfaqe prej 5475m², në vendin e quajtur " Jezero, ", tokë ndërtimore, , e cila në pjesën veriore kufizohet me parcelën 1467-0- nga pika 1 deri te pika 2 me gjatësi prej 149.98 dhe nga pika 2 deri në pikën 3 me gjatësi 109.69m, nga ana lindore kufizohet me parcelën nr.1469-0 nga pika 3 deri në pikën 4 me gjatësi prej 2.70 m dhe me parcelen nr.1475-0 nga pika 4 deri te pika 5 me gjatësi prej 19.35 m, nga ana jugore me parcelën nr. 1476-0 nga pika 5 deri te pika 6 me gjatësi prej 113.66 m, dhe nga pika 6 deri te piak 7 me gjatësi prej 152.25 m, dhe nga ana Perendimore me parcelën nr.170-2 nga pika 7 deri te pika 1 me gjatësi prej 20.84 m, fakte këto të vërtetuara me shiqimin në vend nga gjykata si dhe përmes ekspertizës gjeodezike.

Pas administrimit të provave dhe vlerësimit të pretendimeve të palëve ndërgjyqëse, e duke u mbështetur në nenin 8 të LPK-së, gjykata erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit dhe e ndërhyrsit kryesor është e bazuar, andaj edhe ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Baza ligjore dhe vlerësimi përfundimtar i gjykatës

Me dispozitat e Ligjit për Marrëdhëniet Themelore Juridike Pronësore, të datës 30.01.1980 (Gazeta zyrtare e RSFJ-së nr.6, LMTHJP), i cili ligj ishte në fuqi në kohën e krijimit të raporteve nga marrëdhënia pronësore mes palëve, në nenin 20 është përcaktuar *“E drejta e pronësisë fitohet sipas vetë ligjit, në bazë të veprimit juridik dhe me trashëgim”* në nenin 21 se *“E drejta e pronësisë fitohet, mes tjerash edhe me parashkrim fitues..”*; nenin 28, paragrafi 2 dhe 4 se *“Mbajtësi me mirëbesim dhe i ligjshëm i sendit të paluajtshtëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronsisë mbi këtë send me parashkrim fitues me kalimin e kobës prej dhjetë vjetësh. Mbajtësi me mirëbesim i sendit të paluajtshtëm, mbi të cilin tjetri ka të drejtën e pronësisë, fiton të drejtën e pronësisë mbi këtë send me parashkrimin fitues me kalimin e kobës prej 20 vjetësh”*. Ndërsa neni 70 i po të njëjtit ligj përcakton se *“Posedimin e sendit e ka çdo person që ushtron drejtpërdrejt zotërimin faktik të sendit (posedimi i drejtpërdrejtë)”*. Pra janë plotësuar kushtet për fitimin e pronësisë në bazë të parashkrimit fitues, ku sendi duhet të jetë i paluajtshtëm; posedimi i sendit me mirëbesim; dhe të kaloj koha e caktuar me ligj dhe në rastin konkret plotësohen kumulativisht të tri këto kushte.

Ndërsa në nenin 266.1 të LPK-së është e cekur se,, *Personi që tërësisht apo pjesërisht e kërkon sendin apo të drejtën lidhur me të cilën është në zhvillim e sipër procedura midis dy palëve ndërgjyqëse, mundet që në gjykatën e çështjes t'i padisë ato me padinë e tij deri në përfundimin e procedurës me vendim të formës së prerë (ndërhyrja kryesore).*

Gjykata, nga përmbajtja e padisë, parashtrësës për ndërhyrës kryesor , provave të bashkëngjitura së njëjtës, ekspertizës gjeodezike e deklaramit të dëshmitarëve, gjeti se paditësi dhe ndërhyrësi kryesor janë mbajtës me mirëbesim i paluajatshterisë që nga viti 1976 e tutje dhe e shfrytëzojn pronën në mënyrë të pandërprerë, të papenguar e të pashqetësuar nga askush.

Vendimi për shpenzimet procedurale

Për shpenzimet e procedurës gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi ashtu që konform nenit 452.4 të LPK, shpenzimet e procedurës i bartin në menyrë barabartë paditësi dhe ndërhyrësi kryesor .

Nga të lartcekurat, e duke u mbështetur edhe në nenin 2 lidhur me nenin 142 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
C.nr.1006/2020, dt.24.10.2024**

Gjyqtari,
Nexhat Aliu

Këshillë Juridike: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 15 ditëve pas ditës së pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa në kopje të mjaftueshme, dorëzohet nëpërmjet kësaj gjykate.